



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

*Dhjetor, 2017*

Aktiviteti i SBASHK-ut me të zgjedhurit e ri për Këshillin Drejtues  
**Përgatitje për përballje të suksesshme me sfidat e kohës**



Në kuadër të angazhimeve për forcimin e kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social SBASHK-u ka organizuar një varg trajnimesh me anëtarësinë duke përgatitur kështu më shumë se 700 veprimtarë në tërë Kosovën që ata të punojnë me kolegët e tyre pikërisht për t'u përgatitur që sa më mirë e në funksion të realizimit të kërkesave të realizojnë dialogun social ... (faqe 5)

U mbajt Kuvendi zgjedhor i SUSHK-ut

**SUSHK-u është pjesë e respektuar e SBASHK-ut**



Pasi janë kryer sipas agjendës së përgatitur nga Këshilli Drejtues i SBASHK-ut.... (faqe 6)

SBASHK-u u takua me përfaqësues të lartë të FMN-së

**U fol për gjendjen aktuale në arsim dhe për kërkesat e anëtarësisë**

Misioni i Fondit Ndërkombëtar Monetar i kryesuar nga Stephanie Eble,...(faqe 8)

*Intervistë me të zgjedhurit në Kuvendet sindikale të tri niveleve arsimore në kuadër të SBASHK-ut*

**Janë të sigurt se me punë e angazhime do ta arsyetojnë besimin e kolegëve**

**Blerim Mehmeti  
Vjollca Shala  
Bardh Bardhi ... (faqe 3)**

Kuvende zgjedhore të dy niveleve arsimore në kuadër të SBASHK-ut

**Sindikalistët nga arsimit fillor dhe ai i mesëm me kryetarë të rinj**



Pas Kuvendit zgjedhor të sindikatës së Universiteteve në kuadër të SBASHK-ut janë ... (faqe 7)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture

## Editorial

### Po shkon edhe viti 2017



Është ky muaji dhjetor. Edhe viti 2017 po shkon dhe të gjithë pajtohemi se ditët po ikin shpejt. Jemi munduar bashkë kolegë e kolege kudo jeni që të shënojmë arritje sa më të mëdha bashkë e në SBASHK. I shtruar detyrë veti, që krahas përpjekjeve për realizimin e kërkesave tona, të respektojmë në përpikëri Statutin dhe agjendën e zgjedhjeve sepse e 2017-ta ishte vit i zgjedhjeve. Detyrën e morëm me seriozitet dhe zgjedhjet, që nga niveli i shoqatave e pastaj edhe në Kuvendet e niveleve komunale dhe në Universitete kishin rrjedhë të shkëlqyer. Vota e fshehtë dhe gara e fortë kanë bërë që të zgjedhën ata që ju menduat se janë më të përgatiturit për momentin për të marrë detyra të reja e për t'i realizuar ato.

Kemi bërë edhe shumë angazhime dhe janë shënuar arritje, por na mbetget edhe punë për të bërë.

Me qëllim që t'ju mbajmë të informuar dhe të ndajmë arritjet, sfidat dhe idetë për të ardhmen në shenjë respekti për ju zyra për informim ka përgatitur gazetën vjetore me titullin simbolik *"Rrugëtimi i SBASHK-ut 2017"*. Këtë dhuratë modeste do ua dërgojmë në adresat tuaja elektronike e po ashtu do ta botojmë, mundësisht, në një numër të caktuar ekzemplarësh për t'ua ndarë miqve tanë, pra miqve të SBASHK-ut.

Duke ju uruar Vitin e Ri përcjell të ju lutjen që të gjithë ju të keni shëndet të mirë dhe të shënoni arritje të reja në vitin që po vjen. Gëzuar pra të nderuarit kolegë e kolege – punëtorë të arsimit kudo jeni. Fat e suksese për ju dhe familjet tuaja të nderuara.



Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

*Intervistë me të zgjedhurit në Kuvendet sindikale të tri niveleve arsimore në kuadër të SBASHK*

### Janë të sigurt se me punë e angazhime do ta arsyetojnë besimin e kolegëve

#### **Arsimimi sot:**

Kush është Blerim Mehmeti ?



Blerim Mehmeti, i lindur në Përlepnice më, 29.03.1967, me një përvojë mbi 20 vjeçare në procesin edukativo-arsimor. Shkollën e Lartë Pedagogjike e kam kryer më 08.05.1992

Kam përfunduar Fakultetin e Edukimit më, 01.03.2014.

Mësimet e fituara dhe përvojën e arritur në vazhdimësi e kam praktikuar me nxënës, si punë parësore.

Që nga punësimi im, pra nga viti 1996 jam edhe pjesë e organizimit sindikal, fillimisht si anëtar e pastaj edhe si udhëheqës i shoqatës në shkollën "Skënderbeu".

Nga marsi i vitit 2013 jam udhëheqës i SBASHK-ut në nivel komunal, pozitë në të cilën jam edhe aktualisht. Në dhjetorin e vitit 2017 në Kuvendin zgjedhor të sindikatës së Arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët jam zgjedhur kryetar i këtij Kuvendi.

#### **Arsimimi sot :**

Cili do të jetë aktiviteti juaj si kryetar në detyrën e re?

#### **Blerimi:**

Janë bërë shumë angazhime dhe janë shënuar shumë arritje në SBASHK, por ka edhe punë për t'u bërë në mënyrë që të realizojmë në vazhdimësi

Duke u nisur nga këto çështje ne do të vazhdojmë të punojmë bashkërisht në realizimin e projekteve të ndryshme lidhur me sektorin tonë, pra duke pasur parasysh edhe specifikat e veçanta të këtij sektori.

Duke mos dashur të zgjatëm shumë në ekspozenë time kërkoj besimin tuaj që të më fuqizoni me votën tuaj dhe që bashkërisht ti realizojmë të drejtat tona dhe projektet tona çfarë do qofshin ato projekt që do ti

sillni ju apo ti sjellim bashkërisht si ide dhe ato pastaj ti jetësojmë.

#### **Arsmimi sot :**

Kush është Vjollca Shala ?



Kam lindur në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme e kam mbaruar në Mitrovicë. Inxhinierë e diplomuar e elektroteknikës drejtimi "Kompjuterikë me Telekomunikacion". Master i shkencave kompjuterike. Magjistër i Informatikës. Profesoreshë e TIK -ut në Gjimnazin "Frang Bardhi" në Mitrovicë .Kryetare e Sindikatës Komunale të Arsimit fillore dhe të mesëm në Mitrovicë dhe tani Kryetare e Sindikatës së Arsimit të Mesëm të Lartë të Kosovës.

#### **Arsimimi sot :**

Cili do të jetë aktiviteti juaj si kryetar në detyrën e re?

#### **Vjollca:**

Si Kryetare e Sindikatës së AML në plotësi do ti përmbahem Statutit dhe akteve tjera të SBASHK-ut ku në mënyrë të detajuar janë konkretizuar detyrat dhe obligimet. Në bazë të akteve normative kam bërë plan programin e punës të detajuar në baza mujore, tre mujore, gjashtë mujore, nëntë mujore dhe vjetore. Gjithnjë në zgjidhjen e problemeve arsimore dhe mbrojtjen e punonjësve të arsimit për të drejtat në punë dhe të drejtat nga marrëdhënia e punës. Maksimalisht do të angazhohemi në rritjen e numrit të anëtarësisë të AML në SBASHK. Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me kryetarët e

shkollave të mesme do të jemi të informuar për të gjitha ndryshimet që po ndodhin në AML, vlen të përmendet ndryshimi i kualifikimit të nevojshëm, ku të gjitha këto do ti përcjellim në qendër me qëllim të gjetjes së një zgjidhje më të mirë të mundshme.

## **Arsimimi Sot:**

Kush është Bardh Bardhi?



Bardh Bardhi, ka lindur me 13.08.1957, në Stankaj të Rugovës, Pejë. Shkollën e fillore e ka kryer Bogë dhe Trestenik të Pejës. Shkollën e mesme e ka kryer në Gjimnazin “11Maji” tash “Bedri Pejani” në Pejë. Fakultetin e ka kryer në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë në vitin 1981/82.

Shkallen e tretë-magjistraturën e ka regjistruar në vitin 1985/86 semestrin e parë-dytë, vitin 1986/87 semestrin e tretë-katërtë, si gjeneratë e parë në Universitetin e Kosovës, (por për shkaqe objektive nuk e ka përfunduar)

Punësohet në “Agrokosova –Commerce” në vitin 1981/82 si praktikantë dhe pastaj deri në vitin 1991-janar kur largohet nga puna si Udhëheqës i departamentit të Export-Importit .Pastaj vazhdon të punojë në Biznes privat si bashkëpronar dhe Menaxher i export-importit në firmën”Edi-Impex”me seli në Mitrovicë deri në vitin 1996.

Prej vitit 1996/97 fillon punën në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë si Menaxher –Udhëheqës i kontabilitetit dhe financave ku edhe tani është i punësuar- duke punuar me kohë të pacaktuar.

Bardhi, është i martuar ka gruan dhe dy vajza, Gruaja ka të kryer Fakultetin Ekonomik, dhe punon. Vajzat kanë të kryer Fakultetin dhe Master në Fakultetet gjegjëse: njëra ekonomik-menaxhment, tjetra sundim të ligjit – juridik dhe punojnë të dyja .

Jeton dhe vepron në Prishtinë që nga viti 1976 .

## **Arsimimi sot:**

Cila është porosia juaj pasi jeni rizgjedhur në pozitën e kryetarit të SUSHK-ut në kuadër të SBASHK-ut ?

## **Bardhi:**

Unë do të vazhdoj me tërë dijen dhe mundësitë e mija e në bashkëpunim me kryesinë e SUSHK dhe me SBASHK-un në përpjekje për të realizuar në tërësi kërkesat e anëtarësië në Univeristete , por edhe në nivelet tjera të Arsimit.

Porosia ime për anëtarët e SBASHK-ut është të punojmë me ndërgjegje të plotë për të mirën tonë dhe të fëmijëve tanë, të angazhohemi ma shumë në zbatimin e Statutit të SBASHK-ut dhe të Ligjit mbi organizimin Sindikal. Po ashtu kam një porosi që njohuritë dhe përvojat e marra nga Seminaret, Konferencat e ndryshme që organizohen nga SBASHK ne bashkëpunim me organizatat e cekura me lartë ti përmiellim të Anëtarësia e gjerë neper Shoqatat Sindikale ku punojmë dhe veprojmë. Posaqërisht, do të angazhohemi në ngritjen e statusit të mësimdhënësve.

Në partneritet me MASHT-in, odën ekonomike dhe bizneset e Kosovës do të punojmë në hapjen e shkollave profesionale me drejtime dhe plan programe të posaçme bazuar në nevojat e tregut të punës, bashkëpunim të veçant do të zhvillojmë edhe me shkollat profesionale ndërkombëtare për hapjen e tyre te ne. Të mundohemi të aplikojmë sistemin Gjerman për përgaditjen e kuadrave të specializuar.

Në bashkëpunim me MASHT-in dhe Arsimin e Shqipërisë do të punojmë në hartimin, harmonizimin dhe unifikimin e teksteve mësimore për shkollat e mesme të larta.

Të kontribuojmë në trajnime dhe aftësim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve.

Do të jemi gjithnjë aktiv në ndryshimet, plotësimet dhe realizime të Marrveshjeve Kolektive, njëherit do të monitorojmë implementimin e Kontratës Kolektive. Posaqërisht do të angazhohemi në unifikimin e qëndrimeve sindikale për problemet eventuale.

## Gjatë muajit

### Aktiviteti i SBASHK-ut me të zgjedhurit e ri për Këshillin Drejtues **Përgatitje për përballje të suksesshme me sfidat e kohës**

*Në kuadër të angazhimeve për forcimin e kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social SBASHK-u ka organizuar një varg trajnimesh me anëtarësinë duke përgatitur kështu më shumë se 700 veprimtarë në tërë Kosovën që ata të punojnë me kolegët e tyre pikërisht për t'u përgatitur që sa më mirë e në funksion të realizimit të kërkesave të realizojnë dialogun social me palët tjera. Këto trajnime janë vlerësuar lartë nga pjesëmarrësit në to dhe kanë krijuar mundësinë e bashkëbisedës me anëtarësinë për të gjitha çështjet sindikale. Në vazhdimësi të këtij aktiviteti të rëndësishëm dhe me qëllim që të zhvillohet në bashkëbisedë me anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues SBASHK-u ka organizuar një trajnim tre ditor me ta.*



Në hapje të këtij aktiviteti kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj duke përshëndetur pjesëmarrësit e duke i uruar për besimin që u kanë dhënë Kuvendet zgjedhore në komunat e tyre ka folur fillimisht për Këshillin Drejtues dhe për rëndësinë e tij në kuadër të organogramit të SBASHK-ut. Pas kësaj është hapur një bashkëbisedë dhe të zgjedhurit e ri për Këshillin Drejtues kanë shtruar pyetje dhe kanë dhënë ide të shumta lidhur me angazhimet që ata bashkërisht do të bëjnë që në marsin e vitit 20218 e tutje për të arsyetuar besimin që Kuvendet Komunale të SAF e SAM u kanë dhënë .

Pas kësaj është kaluar në temat kyçe të trajnimit, të cilin e kanë udhëhequr trajnerët e licencuar për dialogun social , Ymer Ymeri e Vjollca Shala , të ndihmuar aty e këtu edhe nga kryetari Jasharaj.



Të dy trajnerët e licencuar për dialogun social kanë shpalosur shumë çështje duke u ndalur në veçanti të temat: "Definicioni për dialogun social", " Funksioni dhe sfidat e dialogut social", "Dialogu social në kontestin kombëtar dhe në atë ndërkombëtar".



Këto dhe tema të tjera trajnerët i kanë shpalosur , jo në mënyrën klasike të ligjërimit, por duke krijuar atmosferë të bashkëbisedës me pjesëmarrësit e trajnimit për gjithë çështjet me rëndësi duke mos e marrë dialogun të ndarë vetëm në aspektin social, por kanë marrë shembuj dhe janë angazhuar të gjejnë



modelet me të mira të qasjes në dialogun me nxënësin, kolegët, me drejtorin dhe me prindërit dhe komunitetin në tërësi.

Pjesëmarrësit e trajnimit, që janë anëtarët e ri të Këshillit Drejtues kanë parë nga afër sfidat dhe shqetësimet që krijon dialogu me palën tjetër në ditën e tretë të trajnimit kur disa nga ta janë gjetur në pozicionin e përfaqësuesve sindikal e të tjerët në atë të

drejtorit të shkollës, të DKA-së apo të institucioneve të pushtetit lokal a qendror. Ata kanë dëshmuar se kanë fituar njohuri të mira për dialogun social dhe prandaj edhe do të pajisen me certifikata, pasi që ky trajnim është i licencuar. Ata do të jenë të përgatitur për të marrë përgjegjësitë e obligimet në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Drejtues, që është organi më i lartë i SBASHK-ut mes dy Kongreseve.

## U mbajt Kuvendi zgjedhor i SUSHK-ut **SUSHK-u është pjesë e respektuar e SBASHK-ut**

Pasi janë kryer sipas agjendës së përgatitur nga Këshilli Drejtues i SBASHK-ut zgjedhjet në njësitë akademike të Universiteteve të Kosovës janë mbajtur zgjedhjet edhe në Kuvendet e këtyre institucioneve të larta të arsimit të Kosovës dhe kështu është krijuar mundësia për mbajtjen e Kuvendit zgjedhor të Sindikatës së Universiteteve e Shkencës të Kosovës (SUSHK), që është pjesë e respektuar e SBASHK-ut.



Kjo ngjarje e rëndësishme është mbajtur në ambientet e Fakultetit Filologjik të Prishtinës dhe në të kanë marrë pjesë të gjithë delegatët e zgjedhur nga kolegët e tyre në Universitetet e Kosovës. Të pranishëm në këtë Kuvend zgjedhor ishin edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, që edhe në këtë Kuvend zgjedhor ishte në cilësinë e kryetarit të Komisionit Statutor.

Kryetari i SUSHK-ut, z. Bardh Bardhi në fjalën e tij hyrëse ka lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut e

pastaj ka shpalosur momente kyçe të aktiviteteve duke prezantuar raportin e punës, të cilin delegatët e kanë aprovuar. Kryetari Bardhi ka prezantuar pastaj edhe raportin financiar, i cili po ashtu është aprovuar nga pjesëmarrësit e këtij takimi.



Me qëllim që procedura e zgjedhjeve të shkojë sipas rregullave të qarta nga Statuti i SBASHK-ut lidhur me këtë çështje, kryetari i Komisionit statutor, Ymer Ymeri ka dhënë sqarime lidhur me ecurinë e zgjedhjeve duke veçuar se për çdo post duhet të ketë dy e më shumë kandidatë dhe se zgjedhjet bëhen përmes votës së fshehtë.



Në një garë të fortë për çdo pozitë udhëheqëse në SUSHK përmes votës së lirë e të fshehtë kryetar i SUSHK-ut është rizgjedhur Bardh Bardhi. Nënkrjetare u zgjodh Blerta Mehmedi, kurse anëtarë të kryesisë Armend Hysa nga Universiteti i Ferizajt, Përparim Avdullahu, Mustafë Emini, Afrim Çela, Azem Kyçyku, Nazim Merovci, Besim Cakolli, Fahrie Gashi dhe Gjylasie Berisha. Në Komisionin mbikëqyrës janë zgjedhur Safet Thaçi, Besa Guholli

dhe Meriton Shabani. Universitetet e Kosovës, gjegjësisht SUSHK-un në Kongresin VII të SBASHK-ut do ta përfaqësojnë Besa Rexhepi, Vera Sopi dhe Mimoza Alaj, ndërsa në Këshillin Drejtues Elez Krasniqi e Arta Rudi me zëvendësuesit e tyre eventual Demë Ibërdemaj e Fehmi Ramadani.

Të zgjedhurit janë zotuar se do të punojnë bashkërisht për realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe se do të jenë shembull i mirë i unitetit në SBASHK.

Kuvende zgjedhore të dy niveleve arsimore në kuadër të SBASHK-ut

## Sindikalistët nga arsimit fillor dhe ai i mesëm me kryetarë të rinj

Pas Kuvendit zgjedhor të sindikatës së Universiteteve në kuadër të SBASHK-ut janë mbajtur të shtunën dhe të dielën në Sallën e Qendrës së studentëve edhe Kuvendet zgjedhore të Sindikatës së Arsimit parafillor, fillor e të mesëm të ulët dhe edhe Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit të Mesëm të Lartë në kuadër të SBASHK-ut.



Në hapje të të dy Kuvendeve zgjedhore në fjalën përshëndetëse kryetari i SBASHK-ut duke përshëndetur delegatët i ka falënderuar ata që, edhe në ditë vikendi, kanë ardhur në këto takime dhe kështu kanë shprehur besimin dhe unitetin ndaj SBASHK-ut. Nëpjesëne parë të Kuvendit Sindikatës së Arsimit parafillor, fillor e të mesëm të ulët, që u mbajt të shtunë, 23 dhjetor, është lexuar raporti i punës nga kryetari i deri tashëm i këtij Kuvendi, Murat Abazi e pas kësaj është kaluar te procesi zgjedhor.



Për të shkuar zgjedhjet sipas rregullave të parapara në Statutin e SBASHK-ut, kryetari i Komisionit statutar, Ymer Ymeri, ka dhënë shpjegime të nevojshme dhe pastaj është kaluar në procesin e zgjedhjeve. Pas numërimit të votave është konstatuar se kryetar i ri i këtij Kuvendi është Blerim Mehmeti, kurse Nënkrjetar është zgjedhur Besart Ismajli. Kuvendi pas kësaj ka zgjedhur edhe 7 anëtarët e kryesisë së sindikatës së arsimit fillor në kuadër të SBASHK-ut duke respektuar përfaqësimin nga të gjitha regjionet e Kosovës. Anëtarë të kryesisë janë zgjedhur: Ahmet Pllana- regjioni i Prishtinës, Teuta Dërguti- regjioni i Mitrovicës, Isuf Lajçi-regjioni i Pejës, Shpend Canamusa- regjioni i Gjakovës, Hyrie Hoti nga regjioni i Prizrenit, Avni Isufi nga regjioni i Ferizajt dhe Besim Kryeziu nga rajoni i Gjilanit.

**Pas kuvendit të së shtunës, të dielën, më 24 dhjetor, është mbvajtru edhe Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit të Mesëm të Lartë në kuadër**

të SBASHK-ut. Edhe pse ishte e dielë në Sallën e mbledhjeve të Qendrës së studentëve, kishin ardhur numër i madh i përfaqësuesve të shkollave të mesme të Kosovës . Pas hapjes së këtij takimi dhe fjalës përshëndetëse të kryetarit të SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, kryetari i komisionit statutar, Ymer Ymeri ka dhënë shpjegime lidhur me procedurën zgjedhore.



Në nja garë të fortë e me shumë kandidime përmes votës së fshehtë janë zgjedhur organet udhëheqëse të Kuvendit të Sindikatës së Arsimit të Mesëm të Lartë.



Vota e lirë dhe e fshehtë e anëtarëve të këtij Kuvendi nga e tërë Kosova ka bërë që kryetare e Kuvendit të SAMK të zgjidhet Vjollca Shala, kurse nënkryetar Rexhep Sadiku.

Në pjesën e dytë të votimeve delegatët kanë dhënë shumë propozime për anëtarë të kryesisë duke respektuar edhe parimin që në kryesi të jenë të përfaqësuar të gjitha regjionet. Përmes votës së fshehtë anëtarë të kryesisë janë zgjedhur:



Hazbi Gashi- regjioni i Prishtinës, Hysen Ademi- regjioni i Mitrovicës, Besa Shala- regjioni i Pejës, Bedrush Zeka- regjioni i Gjakovës, Ganimet Mrasori- regjioni i Prizrenit, Hanife Salihu- regjioni i Ferizajt dhe Kemajl Bislimi- regjioni i Gjilanit.



Në një fjalë përshëndetëse dhe falënderimi për besimin e dhënë , Vjollca Shala , duke u shprehur edhe në emër të kryesisë së sapo zgjedhur, ka premtuar angazhim të përkushtuar në mënyrë që të jenë zë i vërtetë i të gjithë të punësuarve në Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës në kuadër të SBASHK-ut.

SBASHK-u u takua me përfaqësues të lartë të FMN-së

## U fol për gjendjen aktuale në arsim dhe për kërkesat e anëtarësisë

Misioni i Fondit Ndërkombëtar Monetar i kryesuar nga Stephanie Eble, zëvendës shef i njësisë lindore evropiane dhe Ruud Vermeulen Përfaqësues i Përhershëm në Kosovë i këtij institucioni ndërkombëtar në kuadër të takimeve të shumta me krerët më të lartë të Qeverisë dhe institucioneve tjera

kanë ftuar në një takim me karakter bashkëbisede e informimi të ndërsjellë edhe përfaqësuesit e sindikatave të Kosovës.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë përsëritur edhe para misionit të FMN-së qëndrimin e anëtarësisë në kundërshtim të paralajmërimit të rritjes së pagave në



sektorin publik prej vetëm 4 %. Një rritje kaq të ulët të pagave ata e kanë konsideruar si të papranueshme dhe kanë shprehur shqetësimin nëse nuk do të ndodh ngritje më e madhe e pagave do të ketë pakënaqësi të mëdha mes punëtorëve të arsimit dhe të sektorëve të tjerë, pakënaqësi këto që do të qojnë në greva të përgjithshme.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri në bashkëbisedë më përfaqësuesit e lartë të FMN-së kanë treguar për gjendjen në arsim dhe për angazhimet e SBASHK-ut për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë përsëritur edhe para misionit të FMN-së qëndrimin e anëtarësisë në kundërshtim të paralajmërimit të rritjes së pagave në sektorin publik prej vetëm 4 %. Një rritje kaq të ulët të pagave ata e kanë konsideruar si të papranueshme dhe kanë shprehur shqetësimin nëse nuk do të ndodh ngritje më

të madhe të pagave do të ketë pakënaqësi të mëdha mes punëtorëve të arsimit dhe të sektorëve të tjerë, pakënaqësi këto që do të qojnë në greva të përgjithshme. Delegacioni i SBASHK pastaj ka kërkuar nga zëvendës shefi i njësisë

lindore evropiane dhe Përfaqësuesi i Përhershëm në Kosovë i FMN-së që në takime me krerët e lartë institucional të ndikojnë që në buxhetin e Kosovës për vitin 2018 të krijohet vijë buxhetore për realizimin e Kontratës Kolektive të Arsimit pa pasur nevojë të vazhdohet me procedimin e lëndëve në gjykata, lëndë këto që janë duke u fituar, por SBASHK-u nuk po ndihet mirë sepse përmes procesit të fituar në gjykata po dëmtohet buxheti i Kosovës sepse , krahas mjeteve në emër të shpërblimeve jubilarë dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit komnat detyrohen të paguajnë edhe një shumë të konsiderueshme në emër të taksave të parapara me ligj . Anëtarët e Misionit të FMN-së janë shprehur se duke respektuar sindikatat si përfaqësuese të punëtorëve në Kosovë janë takuar për të dëgjuar vlerësimet e situatës aktuale ekonomike në Kosovë nga këndi sindikal. Ata kanë premtuar se takime të këtij niveli do të ketë edhe në të ardhmen dhe se shqetësimet e ngritura të sindikalistëve do të gjejnë vend në raportin e tyre dhe hapësirë të merituar në bisedat me krerët e institucioneve të Kosovës.

SBASHK-u vazhdon me nënshkrimin e marrëveshjeve në shërbim të anëtarësisë

## Marrëveshje të tilla edhe në Podujevë

Krahas shumë angazhimeve për realizimin e kërkesave të anëtarësisë, SBASHK-u tani e sa kohë vazhdon edhe me një aktivitet domethënës duke lidhur marrëveshje me bizneset dhe me institucionet private shëndetësore e rekreative. Këto marrëveshje janë fryt i respektit të njerëzve të vullnetit të mirë ndaj SBASHK-ut dhe punëtorëve të arsimit të Kosovës. Ky angazhim dhe mirëkuptimi i ndërsjellë kanë bërë që të nënshkruhen deri tani më shumë se 120 për zbritje çmimesh nga 3, 5 , 10 e më shumë për qind, zbritje

këto që ndihmojnë në ruajtjen e buxhetit familjar të anëtarësisë sonë. Për të gjitha marrëveshjet e nënshkruara ne ju kemi informuar përmes shkrimeve në gazetën tonë elektronike “Arsimimi sot”, por të njëjtat i kemi botuar edhe në ueb faqen e SBASHK-ut.

Në këtë numër të gazetës sonë po kujtojmë një marrëveshje të tillë për zbritje çmimesh që është bërë në Podujevë mes kryetarit të SAF e SAM për këtë komunë, Fadil Halimi dhe me drejtorin e "AGNESA

GROUP" Mentor Kamerollin për një zbritje çmimesh prej 3 për qind për të gjithë mësimdhënësit llapjanë në të gjitha dyqanet e "AGNESA GROUP". Kjo marrëveshje është shprehje e respektit të "AGNESA GROUP" me seli në Podujevë ndaj mësimdhënësve të Komunës së Podujevës dhe komunave tjera të Kosovës.



Marrëveshja për zbritje të çmimeve vlen për të gjithë mësimdhënësit sindikalistë që posedojnë kartelën identifikuese të SBASHK-ut. Mësimdhënësit sindikalistë me rastin e paraqitjes në "AGNESA



GROUP" për të kërkuar shërbime duhet të identifikohen me kartelën e tyre të SBASHK-ut. Personat që nuk kanë kartelet dhe që nuk janë anëtarë të SBASHK-ut nuk e gëzojnë këtë zbritje. Mësimdhënësit

sindikalistë nuk mund të kërkojnë shërbime shtesë dhe privilegje të shtuara në këto dyqane por do të kenë trajtim sikur gjithë konsumatorët tjerë. Mësimdhënësit sindikalistë duhet të respektojnë Rregulloren dhe Kodin e mirësjelljes në ambientet "AGNESA GROUP". Mësimdhënësit Sindikalistë pagesën e bëjnë sikur blerësit tjerë, marrëveshja për zbritje vlen vetëm me para kesh, por jo me kartelë bankare.

SBASHK-u do të vazhdojë më ekëtë angazhim edhe në të ardhmën me shpresën se bizneset duke lidhur vullnetarisht marrëveshje edhe do t'u përmbahen atyre.

SBASHK-u u drejtohet publikisht deputetëve që të mbështesin kërkesat e kësaj sindikate

## Mbështetni kërkesat tona se do të mbron buxhetin e Kosovës



SBASHK-u i është drejtuar me shkresë zyrtare kryetarit të Komisionit parlamentar për Arsim, z. Ismajl Kurteshit dhe anëtarëve të tjerë të këtij Komisioni

me kërkesën që ata ta ngritin në seancat e parlamentit kërkesat legjitime të SBASHK-ut që kanë të bëjnë me Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta dhe çështjen e mbështetjes buxhetore për realizimin e kërkesave legjitime që dalin nga Kontratat Kolektive e Arsimit të Kosovës.


SBASHK-u përgëzon kryetarin e Komisionit Parlamentar për arsim z. Kurteshi dhe gjithë anëtarët e këtij Komisioni për angazhimin e sinqertë të tyre në ngritjen e këtyre çështjeve, ndërsa të gjithë deputetëve iu drejtohem me apelin që të ndikojnë që në Ligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2018 të ketë vijë buxhetore për realizimin e nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit e që ka të bëjë me 3 pagat suplementare dhe me tri pagat me rastin e pensionimit të punëtorëve të arsimit. Kujtojmë deputetët se duke dëgjuar zërin e arsyeshëm të SBASHK-ut dhe duke përfillur angazhimet e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Arsim ju do të dëshmonit respektin për punën me dekada të punëtorëve të arsimit të Kosovës dhe do të krijonit mundësinë që të

drejtat e tyre të realizohen në mënyrë humane e jo , si po ndodh vazhdimisht përmes Gjykatave. Kujtojmë deputetët se SBASHK-u , në mungesë të gatishmërisë së institucioneve lokale e qendrore për realizimin e të drejtës së garantuar me Kontratën Kolektive për 3 paga suplementare dhe tri paga me rastin pensionimit lëndët i ka dërguar në Gjykatat gjegjëse dhe është duke i fituar të gjitha këto raste , por e keqja është se në këtë formë buxheti i Kosovës po dëmtohet, ngase

përveç pagave suplementare e tri pagave me rastin e pensionimit , punëdhënësi po detyrohet të paguaj edhe vlerën e një page në emër të taksave gjyqësore, pagesës së seancave dhe kamatave. Ju kujtojmë deputet të nderuar se duke ndarë mjete buxhetore në Buxhetin e Kosovës për këto kërkesa legjitime do ta ruanit respektin e mësimdhënësve për ju dhe institucionet e po ashtu edhe do të ruhej dukshëm vetë buxheti .

Një dhuratë modeste për anëtarësinë dhe miqtë tanë

## SBASHK-u boton gazetën vjetore “*Rrugëtimi i SBASHK-ut 2017*”



Me qëllim që respektin ndaj anëtarësisë dhe miqve të shumtë ta shprehim në një mënyrë të veçantë, Kryesia e SBASHK-ut ka përkrahur idenë e Zyrës për informim që në fund të këtij viti të publikojmë një gazetë vjetore duke përfshirë në të informacionet nga ngjarjet dhe veprimtaritë më të rëndësishme të SBASHK-ut.

Gazeta vjetore u titullua “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2017” . Ky titull simbolik tregon se anëtarët e Zyrës për informim kanë dëshirë që të ndajnë bashkë me lexuesit e shumtë kujtimet për angazhimet, sfidat dhe arritjet e SBASHK-ut duke filluar nga janari e deri në dhjetor të këtij viti. Jemi munduar ta bëjmë më të mirën e mundur në mënyrë që gazeta të jetë

përmbajtësore, por edhe e pëlqyer nga ana vizuale. Besoj se ja kemi arritur qëllimit dhe ju lusim që pasi ta keni lexuar përmes botimit elektronik, apo pasi ta keni parë e lexuar edhe botimin e dizajnuar me kujdes do të na shkruani për të na dhënë përkrahje dhe për të na këshilluar se çfarë duhet bërë e çka duhet të kemi

kujdes kur ta botojmë gazetën e radhës “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2018”.

Ju dëshirojmë çaste të bukura në ditët e mbetura të këtij viti dhe suksese e plot arritje të reja në vitin 2018.  
Gëzuar

## *Edhe dhjetori me aktivitete zgjedhore nëpër qendra të Kosovës Edhe në Universitete vërehet unitet në kuadër të SBASHK-ut*

Në përgatitje për mbajtjen e kuvendit zgjedhor sindikal të Universiteteve të Kosovës, janë mbajtur fillimisht zgjedhjet nëpër njësi akademike e pastaj edhe në kuadër të Universiteteve të Kosovës.



Një kuvend i tillë zgjedhor është mbajtur edhe në Universitetin e Ferizajt. Në fillimet e punimeve të këtij Kuvendi kryetari i SUSHK-ut, Bardh Bardhi ka përcjellë përshëndetjet për pjesëmarrësit të kryetarit të SBASHK-ut, Rahman Jasharaj e pas kësaj ka kujtuar

angazhimet e SUSHK-ut në kuadër të SBASHK-ut në përpjekjet për realizimin e kërkesave të të punësuarve në arsimin superior të Kosovës.

Ai ka përmënuar arritjet, por është ndalur edhe te detyrat që duhet kryer në vazhdimësi të angazhimeve të përbashkëta e në shërbim të anëtarësisë, e cila po tregon unitet të shkëlqyer në kuadër të SBASHK-ut duke kontribuar në forcimin e zërit sindikal në gjithë sektorin e arsimit. Pas kësaj është kaluar në procesin zgjedhor, i cili është zhvilluar në mënyrë korrekte e transparente përmes votës së fshehtë në garën mes dy e më shumë kandidatëve për secilin funksion sindikal në kuadër të këtij Kuvendi.

Pas numërimit të votave kryetar është zgjedhur Armend Hysa e nënkryetare Besa Rexhepi. Anëtarë të Kryesisë së këtij Kuvendi janë zgjedhur Binaze Jashari, Halit Mehmeti e Leonora Haliti, ndërsa delegatë për Kuvendin e SUSHK-ut nga ky Universitet janë zgjedhur Armend Hysa e Besa Rexhepi.